



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 931/5 prot.

Datë 04.07.2022

V E N D I M
Nr. 625/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Air” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*” me Nr. REF-26182-04-22-2022, me objekt Loti 3 “*Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane Qarku Fier*”, me fond limit 15.764.800 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 26.05.2022, nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Modifikimin e dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën operatorit ekonomik “Metani” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“Air” SHPK

Rruga “Siri Kodra”, Nr.8340, nr. Pasurie 5/450, Tiranë

“Metani” SHPK

Rruga “Xhorxhi Martini”, Godina 33, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.04.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-26182-04-22-2022, me objekt Loti 3 “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane Qarku Fier”, me fond limit 15.764.800 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 26.05.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 04.05.2022 operatori ekonomik “Air” SHPK, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, ankesën nr. 931/2022 protokoli, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.2.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.2.2. Nëpërmjet shkresës nr.740/2 prot., datë 09.05.2022, protokolluar me tonën me nr.931/2 prot., datë 12.05.2022, autoriteti kontraktor na vë në dijeni për zgjatjen e afatit të shqyrtimit të ankesës deri në marrjen e informacionit të nevojshëm për shqyrtimin e saj.

II.2.3. Në datën 14.06.2022, operatori ekonomik “Air” SHPK ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, pretendime në lidhje me trajtimin e ankesës së tij nga autoriteti kontraktor.

II.2.4. Nëpërmjet shkresës të protokolluar pranë institucionit tonë më nr.931/4 prot., datë 15.06.2022, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi. Gjithashtu, bashkëlidhur

informacionit të mësipërm autoriteti kontraktor ka dorëzuar shkresën nr. 704/2 prot datë 09.06.2022 me objekt “Vendim”, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Air” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.2.5. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Air” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. Konkretisht, në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet si vijon:

“[...] Për sa më sipër bazuar në numrin e orëve të punës të përlllogaritura për realizimin e shërbimit të përcaktuara në shtojcën 6, në dokumentet e tenderit, si dhe pajisjet/mjetet e kërkuara në pikën 7, të kriterëve të veçanta të kualifikimit, KSHA gjykon se numri i punonjësve të kërkuar në gjurmën “c”, të pikës 2, në seksionin 2.3., në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të ndryshohet.

II.3. Në datën 05.05.2022 operatori ekonomik “Metani” SHPK, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, ankesën nr. 946/2022 protokoli, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.3.2. Nëpërmjet shkresës nr.740/1 prot., datë 09.05.2022, protokolluar me tonën me nr.946/2 prot., datë 12.05.2022, autoriteti kontraktor na vë në dijeni për zgjatjen e afatit të shqyrtimit të ankesës deri në marrjen e informacionit të nevojshëm për shqyrtimin e saj.

II.3.3. Nëpërmjet shkresës nr. 714/3 prot datë 13.06.2022 me objekt “Dërgohet vendim mbi ankesën”, protokolluar me tonën nr.946/3 prot., datë 13.06.2022, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë institucionit tonë aktin e trajtimit e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Metani” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3.4. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Metani” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. Konkretisht, në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet si vijon:

“[...] Operatori Ekonomik “METANI” SHPK ka ankimuar kriterin e vendosur në pikën 3, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8, si dhe

specifikimet teknike lidhur me këtë kriter të përcaktuara në dokumentet e tenderit, me pretendimet si vijon: “Përcaktimi i Produktit agjenti biologjik *Bacillus thuringensis israelensis* (Bti), në dy formulime mikrogranula të dispergueshme në ujë (EG) me fuqi 3000 I.T.U./mg dhe Bti granula (G) me fuqi 200 I.T.U./mg. Duke i sjellë në vëmendje Autoritetit Kontraktor dispozitat ligjore të përcaktuara Ligjin 162/2020, neni 36 pika ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin Objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”, përcaktimi i produktit në shtojcën 5, pika ii, nuk është shoqëruar nga fjalët ekuivalente në kundërshtim me dispozitat ligjore përcaktuar në nenin 36, pika ç) të ligjit 162/2020.

I.1.1. Sipas regjistrimit në agjencitë ECHA dhe EPA <https://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-active-substances/-/disas/factsheet/5/PT18> produktet me agjent biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), në dy formulime. Bti mikrogranula të dispergueshme në ujë (EG) me fuqi 3000 I.T.U./mg (Njosi Toksik Nderkombetare/mg) dhe Bti granula (G) me fuqi 200 I.T.U. janë vetëm re dy prodhuesve dhe markave. Ndërsa formulimet me të njëjtin agjent biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), janë disa produkte me formulime të fuqisë I.T.U./mg (Njosi Toksik Nderkombetare/mg) të ndryshme nga sa kërkuar në shtojcën 8, pika 2.3.3, kapaciteti teknik dhe shtojca 5, Pika ii. Në Argumentimin e specifikimeve teknike Autoriteti kontraktor nuk specifikon qartësisht arsyet e përzgjedhjes së fuqisë I.T.U./mg (Njosi Toksik Nderkombetare/mg) dhe Bti granula (G) me fuqi 200 I.T.U. Specifikimet teknike lidhur me fuqinë e produktit agjent biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), në dy formulime:Duke i sjellë në vëmendje Autoritetit Kontraktor Ligjin 162/2020, neni 36 pika 4: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objektin e kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patente, tipin e origjinës apo prodhues specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në rastet përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. Bazuar në listën e produkteve të regjistruar në ECHA dhe të regjistruar gama e produkteve me agjent biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* me fuqi I.T.U. të ndryshme nga kërkesa në shtojcën 5, Pika ii. Oferta e produkteve është e larmishme dhe nga të njëjtat prodhues të dy produkteve kërkuar si kriter kualifikues në shtojcën 8, pika 2.3.3, kapaciteti teknik dhe shtojca 5, Pika ii. Bazuar në regjistrin e ECHA: [Information on biocides \(europa.eu\)](https://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-active-substances/-/disas/factsheet/5/PT18) Autoriteti Kontraktor nuk është në kushtet e mundësies së një mënyre të mjaftueshme, saktë apo kuptueshme të objektit të kontratës. Vendosja e përqendrimit me fuqi 3000 I.T.U./mg për Bti mikrogranula të dispergueshme në ujë (VG) dhe 200 I.T.U. për Bti granula (G) është në kundërshtim me dispozitat ligjore duke përcaktuar ekzaktësisht markën dhe prodhuesin e agjentit biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti). Përcaktimi i markës dhe prodhuesit paracakton detyrimisht Operatorët ekonomik pjesëmarrës në kundërshtim me dispozitat ligjore Ligjit 162/2020... Në shtojcën 8, pika

2.3.3, kapaciteti teknik dhe shtojca 5, Pike ii. Autoriteti Kontraktues kerkon si kriter kualifikues produktin Film monomolekular, nje produkt qe vepron si barriere fizike per kontrollin e larvave te mushkonjave, duhet te jete me baze silikoni, aplikohet ne perqendrimin 1 ml/m2. Operatori Ekonomik ankimues i sjelle ne vemendje Autoritetit Kontraktor dispozitat ligjore te percaktuara Ligjin 162/2020, neni 36 pika ç) te dyja metodave te percaktuara ne shkronjat "a" dhe "b" te pikes 3 te ketij neni, per mallra, sherbime ose pune te ndryshme, te perfshira ne e njëjtin objekt kontrate. Jdo reference duhet te shoqerohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj", percaktimi i produktit ne shtojcen 5, Pika ii, nuk eshte shoqeruar nga fjalet ekuivalente ne kundërshtim me dispozitat ligjore percaktuar ne nenin 36, pika p) te ligjit 162/2020.

Mosshoqerimi me fjalet ekuivalente sipas dispozitave te parashikuara ne Ligjin 162/2020, neni 36 pika ç, kerkesa Ne shtojcen 8, pika 2.3.3, kapaciteti teknik dhe shtojca 5, Pika ii, Film monomolekular qe vepron si barriere fizike per kontrollin e larvave te mushkonjave, duhet te jete me baze silikoni, aplikohet ne perqendrimin 1 ml/m2, eshte ne kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nuk eshte e mbështetur ne legjislacionin e Prokurimit Publik.

Perdorimi i filmit monomolekular sipas percaktimit ne procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim eshte produkt i cili aplikohet ne puseta me uje jo te rrjedhshem me perberje sintetike ose prejardhje hidrokarburesh. Deshirojme te sjellim ne vemendje te autoritetit kontraktor dispozitat ligjore te ligjit 162/2020, nenit 36, per specifikimet teknike pika 3, paragrafi a) te Ligjit 1d2/2020 i cili percakton se. Specifikimet teknike duhet te pershkruajne qarte kerkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar kerkeseve funksionale ose te performances, perfshire karakteristikat mjedisore, me kusht qe parametrat te jene te sakte ne menyre qe t'u japin mundesi ofertuesve te percaktojne objektin e kontrates dhe autoriteteve ose enteve kontraktore te japin kontraten.

Ne shtojcen 8, pika 2.3.3, kapaciteti teknik dhe shtojca 5, Pika ii. autoriteti kontraktor nuk ka percaktuar perberjen kimike te filmit monomolekular duke mos zbatuar dispozitat e nenit 36, per specifikimet teknike pika 3, paragrafi a) të Ligjit 162/2020, duke mos përcaktuar saktë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke mos iu referuar parametrave të saktë në mënyrë që të jepet mundësi OE të përcaktojë kontratën

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi dokumentet e tenderit, si dhe pretendimet e parashtruara ne ankesa nga operatori ekonomik ankimues "METANI" SHPK, dhe konstatoi:

Në pikën 3 të seksionit 2.3, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8, në dokumentet e tenderit, është përcaktuar: 3.Operatori ekonomik ne lidhje me lenden e përcaktuar ne specifikimet teknike, që do te paraqese, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe Certifikatë konformiteti ose cilësie ECHA/ekuivalent.

Lenda qe do te perdoret ne sherbimin e dezinfektimit

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie ECHA/ekuivalent
-----	----------------------	-------------------	--

1	Agjenti biologjik Bacillus thuringiensis israelensis (Bti)		
---	--	--	--

2	Bti granula (G)		
---	-----------------	--	--

3 Monomolekular film

Shënim:

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK certifikatat e cdo produkti jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit perfundimtar. Te dhenat që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Ne pikën ii, në Specifikimet teknike, Shtojca 5, është përcaktuar: “Formulimet dhe përqendrimet e lëndës aktive dezinfektuese që duhet të përdoren:

1. Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), në dy formulime:

(i) Bti mikrogranula të dispergueshme në ujë (EG) me fuqi 3000 I.T.U./mg (njësi Toksike Ndërkombëtare)/mg),

(ii) Bti granula (G) me fuqi 200 I.T.U (Njësi Toksike Ndërkombëtare)/mg,

2. Film monomolekular është një produkt që vepron si barrierë fizike për kontrollin e larvave të mushkonjave, duhet të jetë me bazë silikoni, aplikohet në përqendrimin 1ml/m².

Ne datë, 24.05.2022, organi qendror blerës i është drejtuar me shkresë nr. 841 prot., Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me lëndë “Kërkesë për informacion”, duke kërkuar informacionin si vijon:

- A janë produktet e sipercituara (të cituara në pikën 3, të seksionit 2.3, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit) lëndë Biocide?

- Nëse po, lutemi të na informoni, për secilin produkt, sa subjekte disponojnë Autorizim për tregtimin e tyre.

Në datë 03.06.2022, nëpërmjet shkresës nr. 841/1 (protokolluar me tonën), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka kthyer përgjigje si vijon:

“Lidhur me pyetjen 1.

Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti) është një lëndë aktive që përdoret në përbërje të produkteve biocide ... Filmi monomolekular me bazë silikoni, vepron thjeshtë si barrierë fizike për kontrollin e larvave dhe pupave të mushkonjave dhe për këtë arsye nuk karakterizohet si lëndë biocid.

Lidhur me pyetjen 2:

Subjekti i cili disponon Autorizim për vendosjen në treg për produktet biocide, të cilat kanë në përmbajtje lëndën aktive *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), është subjekti “NRG” SHPK”.

Në nenin 2 “Qëllimi”, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, është përcaktuar [...]

Ne paragrafin e parë, të pikës 1, të nenit 21, të LPP-së, parashikohet: [...]

Pika 2, 3, 4 e nenit 36 të po këtij ligji, shprehet: [...]

Në pikën 7, e nenit 4, përcaktohet: “Ekuivalente” është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlershme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit.

Ne respekt të parimeve të mësipërme, dhe gjithë bazës ligjore të sipërcituar, kriteret dhe specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përfshijnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo nderkombëtar.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoriteti kontraktor duhet të shmangë cdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, apo të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

KSHA gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë.

Ne hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike, autoritetet kontraktorë duhet të mbajë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Nga interpretimi i mësipërm, arrijmë në përfundimin, se e rëndësishme është që përmes vendosjes së kriterëve dhe specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrin të drejtë, të gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

KSHA-ja gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 germa “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriterë që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriterë dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, por pa përcaktuar kërkesa të cilat krijojnë konfuzion, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriterë apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë, për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik.

Në këto kushte, në respektim të parimeve të ligjit “Për Prokurimin Publik” si dhe duke mbajtur në konsideratë shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ku citon: “Subjekti i cili disponon Autorizim për vendosjen në treg për produktet biocide, të cilat kanë në përmbajtje lëndën aktive *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), është subjekti “NRG” SHPK”, KSHA gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike të produkteve të përcaktuara në pikën 3, të seksionit 2.3, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kërkesat e mesiperme me qëllim që të sigurojë artikullin e mësipërm në përputhje me nevojat e tij njëkohësisht duke hapur dhe konkurrencën drejtë operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

Për sa më sipër, pretendimet e ankimuesit “METANI” SHPK, pranohet.

2. Operatori Ekonomik, “METANI” SHPK ka ankimuar specifikimet teknike lidhur me kriterin e përcaktuar në pikën 7, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8, në dokumentet e tenderit, me pretendimet si vijon: “Në teknikën me mjegullim për objektin e kontratës se shpallur nga autoriteti kontraktor, e rendesishme është madhësia në micron e pikles për të mundësuar depërtimin në ambientet sa më te vogla aty ku mënyra të tjera të shpërndarjes së produktit nuk mundet të arrijnë, përcaktim teknik i cili është përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Në zbatim të dispozitës ligjore të nenit 77, pika 1, LPP kërkesat për kualifikim duhet të jene proporcionale te objektin e kontrate. Kërkesat lidhur me presionin e pompën 5 bar dhe prurja duhet të jetë rreth 15 litër/min dhe mjegullim 100 litra/orë, nuk janë në proporcion me objektin e kontratës pasi nuk influencojnë në kapacitetin dhe aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik. Këto kërkesa janë në kundërshtim me nenin 36, pika 3, c). Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetin ose entit kontraktor, duke iu referuar kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës a, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale. Specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, presioni i pompës 5 bar dhe prurja duhet të jetë rreth 15 litër/min dhe mjegullim 100 litra/orë, depozite e pajisur me perzieres janë specifikime teknike të cilat nuk lidhen ngushtë me objektin e kontrates dhe si të tilla janë kritere ekstra ligjore, diskriminuese dhe në kundërshtim me legjislacionin. Kriteret e kërkuara në specifikimet teknike janë në kundërshtim me nenin 36, pika 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Kërkesa e specifikimeve presioni i pompës 5 bar dhe prurja duhet të jetë rreth 15 litër/min dhe mjegullim 100 litra/orë, depozite e pajisur me perzieres është një kërkesë e cila saktëson një proces të veçantë jashtë objektit të kontrates se shpallur dhe specifikimit teknik të teknikes së përdorimit të kërkuar në shtojcën 5,..... Bazuar në dispozitat e përcaktuara në nenin 77, pika 1, nenin 36, pika 3, c), dhe pika 4, kërkojmë ndryshimin e shtojcës 8, pika 2.3.7.2, kapaciteti teknik dhe shtojca 5 Pika iii, Kamiocine Teknike Pompë me presion të lartë mjegullues (nebulizator) që prodhon mjegull të ftohtë, i montuar në një kamioncinë, me sistemi i mjegullimit në 700 litra/orë, madhësi të piklave 80 — 100 mikron, rezervuar jo më pak se 300 litra, jetë i pajisur me përzierës (agitator), Presioni i pompës duhet të jetë 5 bar dhe prurja duhet të jetë rreth 15 litër/min, në

Kamiocine Teknika Pompë me presion të lartë mjegullues (nebulizator) madhesi te piklave 80 — 100 mikron, rezervuar jo më pak se 300 litra.

IV.II Ne shtojces 8, pika 2.3.7.2y kapaciteti teknik dhe shtojca 5 Pika iii, autoriteti kontraktor kerkon si kriter kualifikues disponimin atomizator shpine me motor me lëng, pompa e shpinës duhet të kete një volum jo më pak se 5-10 litra, pompa duhet të kete piphin ne dalje me një diametër (D 1.2 mm. tubi i daljes duhet të jete i drejt pa kënd* aplikimi duhet të jete në kendin 45 0 njedhia duhet të jete vetëm drejt, pa kënde në dalje, tanku i atomizatorit duhet të jete jo më pak se 13 litra. Volumi i ajrit /orë të variojë nga 900 deri në 1300 m3/orë, Shpejtësia minimale e ajrit në dalje të jete 80 mis. Bazuar ne teknikat e percaktuara ne shtojcen 5, autoriteti kontraktor ka percaktuar tekniken e perdorimit per secilin mjet dhe tipologjine e produktit agjent biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), produkti rregullator i rritjes larvacid, ne kerkesen per atomizator slipine, I cili eshte procesi e mjegullimit autoriteti kontraktor kerkon: pompa duhet të kete piphin ne dalje me nje diaimetër 0 1.2 mm, ne tekniken me mjegullim per objektin e kontrates se shpallur nga autoriteti kontraktor, e rendesishme eshte madhesia ne micron f pikles per te mundesuar depertimin ne ambientet sa me te vogla aty ka menyra te tjera te shperndarjes se produktit nuk mundet te arrijne, percaktim teknik i cili eshte percaktuar nga autoriteti kontraktore kerkesa e autoritetit kontraktor lidhur me diametrin e pipthit ne dalje nuk lidhet ngushtesisht me objektin e kontrates e cila eshte madhesia ne micron i pikles e cila nuk është përcaktuar për atomizator shpine me motor me lëng kërkon aplikimi duhet të jetë në këndin 450, rrjedhja duhet të jetë vetëm drejt, pa kënde në dalje volumi i ajrit /orë të variojë nga 900 deri në 1300 m/orë.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi dokumentet e tenderit, si dhe pretendimet e parashtruara në ankesë nga operatori ekonomik ankimues “METANI” SHPK, dhe konstatoi:

[...]

Në këto kushte, KSHA gjykon se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë specifikimet teknike te pajisjeve të përcaktuara në piken 7, të seksionit 2.3, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në dokumentet e tenderit, duke shmangur përcaktimet fikse, dhe duke vendosur në rastet kur kjo është e mundshme intervale apo diapazon parametrash.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kërkesat e mësipërme, me qëllim që të sigurojë realizimin e shërbimit të kerkuar në përputhje me nevojat e tij njëkohësisht duke hapur dhe konkurrencën drejtë operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

Për sa më sipër, pretendimet e ankimuesit “METANI” SHPK, pranohet pjesërisht.

Për sa më sipër, referuar ndryshimeve të gjykuara lidhur me kriteret dhe specifikime të dokumenteve të tenderit, bazuar në nenin 98, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme”, me qëllim rishikimin e specifikimeve të reja dhe ritestimin e çmimeve përkatëse, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, sugjeron anulimin e procedurës së prokurimit objekt – ankimi..”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Air” ShPK, se: “[...] Njësia e prokurimit ka kërkuar midis të tjerave që OE duhet të paraqesin një deklaratë që drejtuesi teknik i shoqërisë nuk është i angazhuar në kontrata të tjera. Kjo kërkesë nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht në procesverbalin e hartimit të kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike. Ju bëjmë me dije se një shoqëri që ka objekt veprimtarie DDD ka vetëm një drejtues teknik me profil të fushës përkatëse kurse AK më anë të kësaj deklaratë kërkon drejtues teknik për çdo kontratë si për kontrata shtetërore ashtu edhe kontrata private. Sa më sipër kërkojmë heqjen e kësaj deklaratë”, si dhe pretendimin se “...kërkojmë heqjen e kërkesës për 2 përgjegjës pasi së pari termi përgjegjës nuk ekziston në shërbimin që prokurohet dhe së dyti kualifikimet e kërkuara nga AK për përgjegjësit janë identikë me ato të kërkuara për drejtuesin teknik, pra në fund rezulton se AK ka kërkuar 3 drejtues teknik.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 8, për Lotin 3 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2. Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt-prokurimi duhet të ketë të punësuar staf si më poshtë:

a) **1 (një) Drejtues Teknik.** Për drejtuesin teknik të paraqitet:

- Diplomë ose certifikatë kualifikimi me profesion Agronom/Shëndet Publik/Biologji/Kimi.
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune. Të paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të lëshuar nga e - albania.
- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune.
- Në zbatim të akteve ligjore, drejtuesi i mesiperm nuk duhet të figurojë i dy punësuar në sektor privat apo publik. Për këtë Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqërisë të paraqes deklaratë perkatese.
- Drejtuesi nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së realizimit të objektit. Për këtë arsye të paraqitet deklarata perkatese nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqërisë.

b) **Minimalisht 2 (dy) persona në rolin përgjegjës** sipas profileve të mëposhtme:

- Diplomë ose certifikatë kualifikimi me profesion Agronom/Shëndet Publik/Biologji/Kimi.
- Duhet të ketë minimalisht 1 (nje) vit eksperiencë pune. Te paraqitet detyruesisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të leshuar nga e – albania.
- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune.
- Përgjegjësitë nuk duhet të jene të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së realizimit të objektit. Për këtë arsye të paraqitet deklarata perkatese nga Administratori/Drejtuuesi Ligjor i shoqërisë.

c) **Minimalisht 6 (gjashtë) persona**, sipas profileve të mëposhtme:

- specialist për operimin e pajisjeve dezinfektuese sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren;
- specialistë për kryerjen e kalibrimin e pajisjeve sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren;
- Për punonjësit e percaktuar në pikën c) të paraqiten certifikata/dëshmi trajnimit të vlefshme për operimin e pajisjeve dhe/ose preparateve, si dhe kontrata pune.

Shënim: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, dëshmon se punonjësit do të jenë të pajisur me Certifikatë për kryerjen e trajnimeve në fushën DDD (pra, të jenë të siguruar sipas kërkesave ligjore në fuqi).

➤ Operatori ekonomik të paraqes deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës

Shënim 1: Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale të punës si dhe diplomat/certifikatat e cdo punonjësi pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.

Shënim 2:

Me qëllim garantimin e gjithëpërfshirjes, për të dhënë mundësi cdo operatori ekonomik për të marrë pjesë në procedurën perkatese të prokurimit, punonjësit e mesipër jo domosdoshmërisht duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë. Punonjësit mund të kontraktohen nga operatori ekonomik enkas për këtë procedurë prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyruesisht do të paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Shënim 3: Stafi që do të angazhohet në këtë kontratë, duhet të paraqesin secili prej tyre një deklaratë, në zbatim të nenit 21 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar” ku të deklarojnë se

nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit me stafin e Autoritetit Kontraktor (Instituti i Shendetit Publik), si dhe me Stafin e Agjencise se Blerjeve te Pergendruara.

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.1.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.1.5. Në nenin 41, pika 1, 2 dhe 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.1.6. Në VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës Kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera Nënligjore të përbashkëta”, pika c e Dispozitave të Përgjithshme, parashikohet:

“c. “Drejtues teknik” funksioni/ne që kanë përgjegjësinë teknike e profesionale, në emër të subjektit që licencohet/lejohet, e që sipas sferës konkrete të veprimtarisë, mund të marrë emërtime të veçanta rast për rast;”

Në seksionin II. RREGULLA BAZË TË LICENCIMIT NGA OSE NËPËRMJET QKL-SË, parashikohet

1. Licencimi nga ose nëpërmjet QKL-së bazohet në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të licencimit.

2. Llojet e vetme të kriterëve që shqyrtohen për një kërkesë për licencë janë kriteret e posaçme.

3. Një apo disa kriterë të hollësishme, sasiore dhe/ose cilësore, zbërthejnë e konkretizojnë një kriter të posaçëm, sipas zbatimit të tij të faktorët e veprimtarisë/veprimtaritë specifike e specialitetet.

4. Kriteret e hollësishme dhe dokumentet përkatëse provuese janë ato të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për rregullat dhe standardet minimale të kryerjes së veprimtarive elementare përkatëse sipas kategorive, nënkategorive, specifikimeve a specialiteteve.

a) Vetëm kriteret e hollësishme që lidhen me një kriter të posaçëm vlerësohen në procesin e shqyrtimit të një kërkesë për licencë.

b) Mungesa e kriterëve të hollësishme nuk përbën arsye për mosshqyrtimin e një kërkesë për licencë apo për refuzimin e saj. Në një rast të tillë, dhënia apo jo e licencës bazohet vetëm në kriteret e tjera të hollësishme në fuqi e që lidhen me kriterin e posaçëm respektiv.

c) Për sa kohë që për një kriter të posaçëm nuk ekziston asnjë kriter i hollësishëm, atëherë ky kriter i posaçëm nuk merret në shqyrtim gjatë shqyrtimit të një kërkesë për licencim. Në një rast të tillë, dhe nëse licenca varet vetëm nga ky kriter i posaçëm, licenca jepet në çdo rast automatikisht.

ç) Kriteret e hollësishme dhe dokumentet përkatëse provuese sipas kategorive, nënkategorive, specifikimeve a specialiteteve publikohen në regjistrin informativ të licencave e lejeve nga ministria apo institucioni tjetër që ka kompetencë lëndore për veprimtarinë, sipas legjislacionit në fuqi, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Licencimit e në përputhje me format e formatet standarde të këtij regjistri, në formate të përshtatshme, duke dhënë, të paktën, numrin e aktit ligjor dhe/ose nënligjor nga i cili burojnë. Vetëm kriteret e hollësishme dhe dokumentet provuese përkatëse, të publikuara në këtë mënyrë, mund të përdoren në procesin e shqyrtimit të një kërkesë për licencë, në të kundërt ato vlerësohen se nuk ekzistojnë.

Ndërkohë në ANEKSI 1 të vendimit të mësipërm, ligjvënësi ka parashikuar: “KATEGORITË E LICENCAVE E LEJEVE QË SI RREGULL TRAJTOHEN NGA OSE NËPËRMJET QKL-SË” [...]

KATEGORIA II.8

SHËRBIME TË TJERA SHËNDETËSORE DHE/OSE HIGJIENO-SANITARE

1. Veprimtaritë që kryejnë “shërbime të tjera shëndetësore ose higjiëno-sanitare” janë ato të përcaktuara në kategorinë II.8 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” 10[10]
2. Veprimtaritë e kësaj kategorie ndahen në dy nënkategori si vijon:
 - a) “shërbime ekspertize higjiëno-shëndetësore” me kodin II.8.A;
 - b) “shërbime ndërhyrëse higjiëno-shëndetësore” të tilla dezinfektimi, deratizimi, dizensektimi dhe të tjera të këtij lloji me kodin II.8.B.
 - c) veprimtari në fushën e shëndetit publik që nuk licencohen sipas një kategorie tjetër me kodin II.8.C.
3. Një subjekt, sipas kërkesës së tij mund të licencohet për një apo të dy këto nënkategori sipas shkallës së plotësimit të kriterëve përkatëse të licencimit.
4. Licenca e këtyre veprimtarive është pa afat.
5. Kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për nënkategorinë A, B, C të veprimtarisë jepen në tabelën 1 më poshtë.

Tabela 1

Kriteret e posaçme	Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme	Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posaçme
Përshtatshmëria e njohurive dhe eksperiencës së personelit	Drejtuesi teknik sipas rasteve specifike	a) Certifikatë për drejtuesin teknik. b) Akt që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës

6. Licencimi i veprimtarive të nënkategorisë A, B, C bëhet sipas grupit II.
7. Licencimi i veprimtarive sipas këtij vendimi fillon më datë 9.6.2009.

III.1.7. Në Ligj nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, në nenin 9 parashikohet:

1. Produktet biocide vendosen në treg pasi janë autorizuar, sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Vendosja në treg e produkteve biocide kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, të cilët, pavarësisht nga sasia e produktit, plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) **për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë të kontraktuar një person, në pozicionin e drejtuesit teknik, të diplomuar në degët biologji, kimi, agronomi ose shëndet publik;**
 - b) kanë mjedise të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit, garantojnë kushte për sigurinë e personelit;

c) kanë klasifikuar, paketuar dhe etiketuar produkte biocide, sipas dokumentacionit të autorizimit të produktit;

ç) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë mjedise të veçanta tregtimi.

III.1.8. Autoriteti kontraktor në aktin e trajtimit të ankesës ka argumentuar: “...Në VKM nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, në Kreun për licencimin e veprimtarive të nënkategorisë II.8.B (lloji i licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit)”, i ndryshuar, janë përcaktuar kriteret e posaçme në lidhje me licencimin e një shoqërie, nga ku rezultojnë ndërmjet të tjerave këto kriteret: [...] Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme – Drejtuesin teknik Drejtuesi teknik sipas rasteve specifike); llojet e dokumenteve provues lidhur me kriteret e posaçme – a) Certifikatë për drejtuesin; b) akt që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës”. Në interpretim të bazës ligjore sa më sipër, gjykojmë se kohëzgjatja ditore normale e punës është jo më pak se 8 orë dhe numri maksimal i orëve shtesë është 48 orë punë në javë. Një person punon në një subjekt të dytë për aq orë sa nuk tejkalohet numri maksimal i orëve shtesë. Në rastin konkret, në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, se ky kriter duhet ndryshuar pasi “dy punësimi është i lejueshëm”, referuar bazës ligjore të sipërpërmendur ku është shprehur Drejtuesi – Teknik duhet të punësohet me kohë të plotë, KSHA gjykon se autoriteti kontraktor referuar kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është vendosur në përputhje të plotë me parashikimet ligjore në fuqi. Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit “Air” SHPK nuk qëndron.

....Në VKM nr. 514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve LKP, të rishikuar”, rezulton se termi “përgjegjës” është gjerësisht i përdorur në (grup njësitë) e profesioneve. Edhe nëse i referohemi VKM-së së sipërcituar, Kontrollorët e dezinfektimit të mjedisit për baktere, insekte, barëra të këqij kryejnë një pjesë apo tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës, ku një pjesë e së cilave janë si më poshtë:

- Punojnë dhe monitorojnë pajisjet për spërkatje dëmtuesit dhe barërat e këqija;
- Trajtojnë, përziejnë dhe depozitojnë kimikatet duke ndjekur udhëzimet për masat e sigurisë të përcaktuara nga prodhuesit dhe legjislacioni në fuqi;
- Kujdesen për të minimizuar dëmtimin në bimë të tjera, në kafshët dhe në mjedisin përreth;
- mbajnë pajisje në mënyrë efikase dhe radhë të sigurt pune;
- zbatojnë rregullat në mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit të njerëzve;
- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës... etj.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, gjykon se punonjësi me pozicion përgjegjës ka për detyrë të realizojë një sërë funksionesh komplekse, të cilat kërkojnë domosdoshmërisht diplomim apo certifikim në një nga profilet e kërkuara (Agronom, Shëndet publik, Biologji, Kimi). Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit “Air” SHPK nuk qëndron.”

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, KPP, vëren se, në pikën 2.3.2/1.a të Kapacitetit teknik, ka përcaktuar kërkesat në lidhje me drejtuesin teknik, ku specifikisht ka kërkuar që drejtuesi teknik nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së realizimit të objektit të prokurimit. Për këtë arsye duhet të paraqesë deklaratë përkatëse nga administratori/drejtuesi ligjor i shoqërisë.

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për heqjen e kërkesës për paraqitjen e deklaratës se drejtuesi teknik nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, vlen të sqarojmë se autoriteti kontraktor në kriteret e kualifikimit për drejtuesin teknik ka përcaktuar dy momente; e para, deklaratë që drejtuesi teknik nuk duhet të figurojë i dy punësuar në sektor privat apo publik dhe së dyti, deklaratë që drejtuesi teknik nuk është i angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së realizimit të objektit. Nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se ky i fundit ngre pretendime për heqjen e kërkesës në lidhje me paraqitjen e deklaratës se drejtuesi teknik nuk është i angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së realizimit të shërbimit objekt prokurimi.

Sa më sipër, KPP gjykon se, referuar legjislacionit të fushës përkatëse, konkretisht VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës Kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera Nënligjore të përbashkëta”, pika c e Dispozitave të Përgjithshme, përcaktohet termi “Drejtues teknik” - funksioni/ne që kanë përgjegjësinë teknike e profesionale, në emër të subjektit që licencohet/lejohet, e që sipas sferës konkrete të veprimtarisë, mund të marrë emërtime të veçanta rast për rast”.

Ndërkohë në Aneksin 1 të vendimit të mësipërm, ligjvënësi ka parashikuar: “Kategoritë e licencave e lejeve që si rregull trajtohen nga ose nëpërmjet qkl-së”, ku konstatohet se; “Veprimtaritë që kryejnë “shërbime të tjera shëndetësore ose higjieno-sanitare” janë ato të përcaktuara në kategorinë II.8 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Veprimtaritë e kësaj kategorie ndahen në dy nënkategori si vijon: a) “shërbime ekspertize higjieno-shëndetësore” me kodin II.8.A; dhe b) “shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore” të tilla dezinfektimi, deratizimi, dizensektimi dhe të tjera të këtij lloji me kodin II.8.B.

Pra sa më sipër, çdo subjekt i cili kryen një nga veprimtaritë e mësipërme duhet të pajiset me licencën përkatëse. Referuar dispozitave të mësipërme, konkretisht pikës 5, konstatohet se në kriteret e posaçme të licencimit, se mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme, si dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për nënkategorinë A, B, C të veprimtarisë, si dokumente provues lidhur me kriteret e posaçme për pajisjen me licencë, kërkohet që drejtuesi teknik duhet të ketë njohuri të përshtatshme dhe eksperiencë për kryerjen e detyrës së drejtuesit teknik, por ndërkohë nga ana tjetër nuk specifikohet se për drejtuesit teknik të licencës së kategorisë II.8.B nuk parashikohet si kriter i posaçëm që ky drejtues teknik të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë subjektit tregtar mbajtës i kësaj tipi licence.

Pra, shoqëritë të cilat kryejnë veprimtari shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore të tilla si dezinfektimi, deratizimi, dizensektimi dhe të tjera, duhet të pajisjen me licencë përkatëse duke plotësuar disa kushte specifike, ku ndër të tjera kërkohet disponimi i një drejtuesi teknik të pajisur me certifikatë dhe kontratë pune. Akoma më tej, në ligjin specifik të fushës, konkretisht Ligjit nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” në nenin 9 pika 2/a të tij “Vendosja në treg e produkteve biocide”, përcaktohet shprehimisht se 2. *“Vendosja në treg e produkteve biocide kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, të cilët, pavarësisht nga sasia e produktit, plotësojnë kriteret e mëposhtme: a) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë të kontraktuar një person, në pozicionin e drejtuesit teknik, të diplomuar në degët biologji, kimi, agronomi ose shëndet publik”*. Pra, ligjvënësi ka parashikuar si kusht të domosdoshëm për kryerjen e veprimtarisë objekt prokurimi, disponimin nga shoqëria të një drejtuesi teknik, për këtë arsye, në rastin konkret operatorët ekonomikë të cilët kërkojnë të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi, janë në të drejtën e tyre të disponojnë vetëm një drejtues teknik sipas të gjitha kërkesave ligjore, por nuk mund të kufizojnë veprimtarinë e tyre, në punësimin me kohë të plotë dhe për më tepër që të jetë i angazhuar në realizimin e vetëm një kontrate, pasi kjo do të ishte diskriminuese për to. Sa më sipër, gjykojmë se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me paraqitjen e deklaratës se drejtuesi teknik nuk është i angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së realizimit të objektit, është një kriter diskriminues i cili kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë, për sa kohë këta të fundit në përputhje me dispozitat ligjore të fushës, për licencimin e veprimtarisë së tyre mund të disponojnë minimumi një drejtues teknik, kështu që kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me objektin e prokurimit dhe nuk i shërben realizimit të tij, pasi kufizon operatorët ekonomikë në ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.1.10. Për sa i përket, pretendimit të operatorit ekonomik ankimues për heqjen e kërkesës në lidhje me dy persona në rolin e përgjegjës, KPP nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, si dhe lloji i kësaj procedure, konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë duhet të disponojnë në stafin e tyre minimalisht 2 (dy) persona në rolin përgjegjës me të njëjtat kualifikime si drejtuesi teknik i shoqërisë.

Referuar ligjit në fuqi, si më sipër cituar, për kryerjen e shërbimit objekt-prokurimi, ligjvënësi ka parashikuar disponimin nga shoqëria të një drejtuesi teknik, por nuk mund të mohojmë se autoriteti kontraktor, për shkak të llojit të shërbimit, specifikimeve teknike mund të kërkojë edhe staf ndihmës për drejtuesin teknik.

Sa më sipër, referuar kërkesës në fjalë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin.

Sa më sipër, gjykojmë se, autoriteti kontraktor nuk mund të përcaktojë rol “përgjegjës”, për sa kohë një kërkesë e tillë nuk është e parashikuar nga ligji, por është në të drejtën e tij, që të kërkojë që një ose disa punonjës të shoqërisë, mund të kryejnë rolin e përgjegjës, por kualifikimi i kërkuar nuk mund të jetë i njëjtë me drejtuesin teknik, ku për këtë të fundit kualifikimet përcakton më ligjin përkatës. Prandaj, sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të marrë masë për të modifikuar kërkesën e mësipërme në lidhje me kualifikimet e personave në rolin përgjegjës. Gjithashtu, theksojmë se, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë numrin e kërkuar për personat në rolin përgjegjës në proporcion më volumin e lotit përkatës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Air” ShPK, se: “[...] Kërkojmë që numri i punonjësve për këtë lot të ulet nga shtatë në tre. Nga përlllogaritja e kohës së nevojshme të trajtimit rezulton se totali i orëve për këtë lot është rreth 38 kurse trajtimi duhet kryer brenda 48 orëve. Bazuar në Kodin e Punës se RSH rezulton se për të kryer këtë shërbim nuk nevojiten më shumë se tre punonjës shërbimi si dhe kërkojmë që në kriteret e kualifikimit të shtohet kërkesa për paraqitjen e listëpagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore pre tre muajt e fundit në mënyrë që KVO të vlerësojë drejt kapacitetet profesionale të OE””, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 8, për Lotin 3 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

a) Minimalisht 7 (shtatë) persona, sipas profileve të mëposhtme:

- specialist për operimin e pajisjeve dezinfektuese sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren;
- specialistë për kryerjen e kalibrimin e pajisjeve sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren;
- Për punonjësit e percaktuar ne piken c) të paraqiten certifikata/dëshmi trajnimi të vlefshme për operimin e pajisjeve dhe/ose preparateve, si dhe kontrata pune.

Shënim: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, dëshmon se punonjësit do të jenë të pajisur me Certifikatë për kryerjen e trajnimeve në fushën DDD (pra, të jenë të siguruar sipas kërkesave ligjore në fuqi).

➤ Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve te punes

Shënim 1: Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale te punes si dhe diplomat/certifikatat e cdo punonjesi prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit përfundimtar.

Shënim 2:

Me qellim garantimin e gjithëpërfshirjes, per ti dhene mundesi cdo operatori ekonomik per te marre pjese ne proceduren perkatese te prokurimit, punonjesit e mesiperm jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjesit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Shënim 3: Stafi që do të angazhohet në këtë kontratë, duhet të paraqesin secili prej tyre një deklaratë, në zbatim të nenit 21 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar” ku të deklarojnë se nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit me stafin e Autoritetit Kontraktor (Instituti i Shendetit Publik), si dhe me Stafin e Agjencise se Blerjeve te Pergendruara.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në

përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.”.

III.2.4. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor konstatohet, se ky i fundit ka pranuar pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “Air” SHPK, konkretisht, si vijon: *“Nisur nga afatet e ekzekutimit të shërbimit objekt prokurimi, numri i orëve të punës të përlllogaritura për realizimin e shërbimit të përcaktuara në Shtojcën 6, në dokumentet e tenderit, si dhe pajisjet/mjetet e kërkuara në pikën 7, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, gjykojmë se, duke marrë parasysh se çdo pajisje vihet në proces pune nga punonjës, si rrjedhim numri i punonjësve të kërkuar duhet të jetë në përpjesëtim me numrin e pajisjeve/mjeteve të përcaktuara në pikën 7, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit. Për sa më sipër, bazuar numrin e orëve të punës të përlllogaritura për realizimin e shërbimit të përcaktuara në Shtojcën 6, në dokumentet e tenderit, si dhe pajisjet/mjetet e kërkuara në pikën 7, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, KSHA gjykon se numri i punonjësve të kërkuar në germën “ç”, të pikës 2, në seksionin 2.3, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të ndryshohet.”*

Sa më sipër, konstatohet se autoriteti kontraktor në aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ka pranuar ndryshimin e kriterit të mësipërm, por nuk ka përcaktuar numrin konkret të punonjësve të domosdoshëm për kryerjen e shërbimi. Pra, autoriteti kontraktor në mënyrë narrative pranon modifikimin e kërkesës së mësipërme, por nuk ka pasqyruar konkretisht numrin e punonjësve që do të kërkojë.

Për këtë qëllim, KPP gjykon, që autoriteti kontraktor të pasqyrojë në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, uljen e numrit të punonjësve të kërkuar, duke e përcaktuar atë në proporcion me shërbimin që kërkohet të realizohet, kohëzgjatjen e nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi, shpeshtësinë e kryerjes së tij, shtrirjes gjeografike, si dhe mjeteve të kërkuara, si dhe në proporcion me volumin e lotit përkatës.

III.3. Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik që: *“të shtohet kërkesa për paraqitjen e listëpagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore pre tre muajt e fundit”*, gjykojmë se referuar metodës së interpretimit sistematik (*domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik*), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, parashikohet se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”*, ndërsa në nenin 111 pika 1

parashikohet “*Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik*”, pra kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizma ligjorë për kundërshtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke dhënë garanci të plotë operatorëve ekonomikë ankimues. Në rastin konkret, KPP gjykon se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriteret minimale kualifikuese, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësisht të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit) duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 118 pika 2 gërma të *lex specialis* parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato “*a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji; b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore; ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji; d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.*” Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknike janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve kualifikuese në një procedurë prokurimi. Sa më sipër, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar vendosjen e kërkesës për paraqitjen e listëpagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për tre muajt e fundit, në mënyrë që të provohet kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë, por është mjaftuar në vërtetimin e këtij fakti vetëm me paraqitjen e kontratës së punës, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret të tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik.

III.4. Për sa i përket pretendimit të operatori ekonomik ankimues për heqjen e Shënimit 2: *“Me qellim garantimin e gjithëpërfshirjes, për t’i dhene mundesi cdo operatori ekonomik per te marre pjese ne proceduren perkatese te prokurimit, punonjesit e mesiperm jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjesit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi. Stafit qe do te deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.”*, KPP gjykon se autoriteti kontraktor, në asnjë moment nuk ka kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë por përkundrazi ka hapur konkurrencën, duke lehtësuar pozitën e operatorëve ekonomikë të cilët kanë interes për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, duke i lejuar ato që jo domosdoshmërisht të kenë punonjësit e mësipërm si pjesë të stafit të tyre, të cilët të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë, por i ka dhënë mundësi atyre që të kontraktojnë punonjës enkas për këtë procedurë prokurimi. Sa më sipër, kërkesa e operatorit ekonomik nuk është diskriminuese, por i shërben hapjes së garës dhe pjesëmarrjes sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Air” SHPK, për modifikimin kriterit me pretendimin se: *“Kërkojmë që mostrat të paraqiten në datën e hapjes së ofertave bazuar edhe në Udhëzimin e APP mbi paraqitjen e tyre pranë AK dhe dokumentacioni shoqërues të jetë sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.933 datë 25.11.2020*

- *Letër Aksesit për lëndën biocide e regjistruar në ECHA*
- *Letër aksesit për produktin e regjistruar në ECHA*
- *Autorizim prodhuesi*
- *Etiketën në gjuhën shqipe dhe të origjinës*
- *MSDS në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e origjinës*
- *Certifikatë regjistrimi në Europë, Kanada ose në USA në gjuhën shqipe dhe të origjinës”,*
Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 8, për Lotin 3 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2. *Operatoret ekonomike me ane te nje deklarate, duhet te marrin persiper të paraqesin prane AK, jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit perfundimtar, per secilin produkt (objekt prokurimi) mostra te shoqeruara me dokumentacion si me poshte:*
 - a. *Certifikatë konformiteti ose cilësie ECHA/ekuivalent.*
 - b. *Certifikate origjine te produktit.*
 - c. *Raport testimi.*

Raport i testimeve përkatëse duhet të jetë lëshuar nga organet kompetente të akredituara jo më herët se ditën e publikimit të njoftimit të kontratës në SPE.

Rastet e deklaratave të rreme, do të konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Mjetet/pajisjet që do të deklarohen detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

III.5.2. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 6, për Lotin 3 “Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit”, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Zonat	Teknikat/Mënyra e ndërhyrjes	Lenda aktive dhe formulimi që do të përdoret	Përqëndrimi i produktit që do të përdoret në trajtim (dozimi)	Sipërfaqja që parashikohet / trajtim (Sasia)	Njësia	Nr total trajtimeve dy (2) vite
Loti 3 Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane "Qarku Fier"							
1	Divjake dhe Plazh	Cold fogging	Bti ËG	1 kg/ha	12	ha	20
		Dozator për lëng për bodrume dhe puseta	Mono molecular film	1 ml/ m2	100	m2	12
		Atomizator shpine me motorr për granula	Bti G	10 kg/ha	2	ha	24
		Pompë me presion të lartë	Bti ËG	1 kg/ha	2	ha	24
2	Fier (zonë urbane)	Atomizator shpine me motorr për lëng	Bti ËG	1 kg/ha	10	ha	20
		Pompë me presion të lartë	Bti ËG	1 kg/ha	6	ha	24
		Dozator për lëng për bodrume dhe puseta	Monomolekular film	1 ml/m ²	1200	m ²	12
		Atomizator shpine me motorr për granula	Bti G	10 kg/ha	1	ha	24
3	Darëzezë, Plazhi i Semanit	Atomizator shpine me motorr për lëng	Bti ËG	1 kg/ha	3	ha	20
		Pompë me presion të lartë	Bti ËG	1 kg/ha	6	ha	24

	Atomizator shpine me motorr për granula	Bti G	10 kg/ha	2	ha	24
	Dozator për lëng për bodrume dhe puseta	Monomolekular film	1 ml/m ²	100	m ²	12

Lloji paisjes sipas teknikave	Sipërfaqja/teknike/trajtim (ha/m ²)	Sipërfaqja totale/teknike/trajtim (ha/m ²)	Koha e nevojshme për trajtim (orë)
"Cold fogging"	12	12	0.75
Atomizator shpine me motorr për granula	2+1+2	5	2
Pompë me presion të lartë.	2+6+6	14	14
Dozator për lëng për bodrume dhe puseta	100+1200+100	1400	16
Atomizator shpine me motorr me lëng	13	13	5.2

Afatet e ekzekutimit: 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës, brenda marrëveshjes kuadër.

III.5.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar

artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.5.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.”.

III.5.5. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.5.6. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:
a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”.

III.5.7. Në Ligj nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, në nenin 2, neni 8 dhe 9 parashikohet:

Neni 2

Ky ligj përcakton dhe rregullon:

- a) vendosjen në treg të lëndëve biocide, produkteve biocide dhe produkteve të trajtuara;*
- b) prodhimin, importin dhe eksportin e lëndëve biocide, produkteve biocide dhe produkteve të trajtuara;*
- c) organizimin dhe funksionimin e kontrollit të organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, në mjediset publike dhe private, përmes produkteve biocide.*

Neni 8

Autorizimi për bërjen të disponueshme për treg të produkteve biocide

- 1. Të gjitha lëndët vepruese dhe produktet biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, që hyjnë, prodhohen dhe/ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen të disponueshme për treg pas pajisjes me autorizim nga autoriteti kompetent.*
- 2. Autoriteti kompetent autorizon produktet biocide, duke lejuar bërjen të disponueshme për treg në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas paraqitjes së dokumentacionit nga personi fizik ose juridik dhe verifikimit nëse dosja i përmbush kërkesat, sipas këtij ligji.*
- 3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, për raste të gjendjeve të emergjencës shëndetësore apo emergjencës civile, kur luftimi i një agjenti biologjik të dëmshëm gjykohet se nuk realizohet me produktet biocide të autorizuara, autorizon importimin dhe përdorimin e kufizuar të produkteve biocide të paautorizuara përmes procesit normal të bërjes së disponueshme për treg. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë deri në 4 muaj dhe për një sasi të argumentuar nga Instituti i Shëndetit Publik, sipas emergjencës.*
- 4. Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide lëshohet për:*
 - a) produkte biocide të prodhuara në vend;*

b) produkte biocide të autorizuar në njërin nga vendet e Bashkimit European, në Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Turqi, Izrael dhe Australi;

c) produktet biocide të prodhuara dhe të autorizuar në vendet e Ballkanit.

5. Rregullat për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurën e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

1. Produktet biocide vendosen në treg pasi janë autorizuar, sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Vendosja në treg e produkteve biocide kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, të cilët, pavarësisht nga sasia e produktit, plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë të kontraktuar një person, në pozicionin e drejtuesit teknik, të diplomuar në degët biologji, kimi, agronomi ose shëndet publik;

b) kanë mjedise të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit, garantojnë kushte për sigurinë e personelit;

c) kanë klasifikuar, paketuar dhe etiketuar produkte biocide, sipas dokumentacionit të autorizimit të produktit;

ç) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë mjedise të veçanta tregtimi.

III.5.8. Në Kreun 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, parashikohet shprehimisht se:

1. Dosja e aplikimit për autorizim për vendosjen në treg të produkteve biocide, së bashku me kërkesën për pajisjen me autorizim, përmban dokumentet e mëposhtme:

a) **Një dosje dhe letër aksesit për produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën III të këtij vendimi;**

b) **Një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, përfshirë:**

- emrin tregtar të produktit biocid;

- emrin dhe adresën e aplikantit;

- përbërjen cilësore e sasiore të produktit lidhur me lëndët vepruese dhe lëndët e tjera jovepruese, si dhe njohuri të domosdoshme për përdorimin e duhur të produktit biocid;

- prodhuesit e produktit biocid (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit);

- prodhuesit e lëndëve vepruese (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit);

- tipi i formulimit të produktit biocid;

- frazat e rrezikut dhe parandalimit;

- tipi i produktit biocid dhe një përshkrim i saktë i përdorimit për të cilin kërkohet autorizimi;

- organizmat target;
- dozat e aplikimit dhe udhëzimet për përdorimin;
- kategoritë e përdoruesve;
- të dhëna mbi ndikime të mundshme direkte apo indirekte të produktit biocid në mjedis dhe përcaktimin e masave përkatëse për minimizimin e këtyre ndikimeve në mjedis;
- udhëzues për nxjerrjen e sigurt jashtë përdorimit të produktit dhe ambalazhit;
- kushtet e ruajtjes dhe jetën e ruajtjes së produktit biocid për kushte normale të ruajtjes;
- informacion tjetër relevant rreth produktit biocid.

c) Një dosje dhe letër aksesit për çdo lëndë vepruese të miratuar, që përmbahet në produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën II të këtij vendimi;

ç) Letra e aksesit duhet të përmbajë së paku informacionin e mëposhtëm:

- emrin dhe detajet e kontaktit të zotëruesit të të dhënave dhe personit të tretë;
- emrin e substancës vepruese ose të produkteve biocide për të cilat është i autorizuar përdorimi i të dhënave;
- datën në të cilën letra e aksesit hyn në fuqi;
- një listë të të dhënave të paraqitura për të cilat letra e aksesit i jep të drejtën e citimit.

d) Aplikanti nuk ka nevojë të paraqesë të dhëna për ekspozimin, nëse nuk parashikohet ekspozim që shoqëron përdorimet e propozuara dhe nuk është e nevojshme shkencërisht që të paraqiten të dhëna, apo nuk është teknikisht e mundur që të prodhohen të dhëna të tilla;

dh) Të dhënat që provojnë se produkti biocid është i autorizuar në një nga vendet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 8, të ligjit nr. 95/2015, dhe është i përfshirë në bazën e të dhënave të Agjencisë Evropiane të Kimikateve për produktet biocide të autorizuar. Aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që zotëron autorizimin e këtij produkti biocid, të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe;

e) Për produktet biocide që janë subjekt i procedurës së thjeshtuar të autorizimit, sipas përcaktimeve në kreun IV, të shtojcës I, të këtij vendimi:

- një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, sipas referimit në pikën 1(a) të këtij kreu;
- të dhënat e efikasitetit; dhe
- çdo informacion tjetër relevant në mbështetje të konkluzionit se produkti biocid plotëson kushtet e përcaktuara në kreun IV të këtij vendimi;
- të dhënat që provojnë se aplikantit i është lëshuar autorizimi i produktit biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që e ka marrë autorizimin e këtij produkti biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian; të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe.

ë) Etiketën përkatëse të produktit biocid, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 487, datë 29.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e produkteve biocide”;

f) Dokumentacioni me të dhënat e sigurisë (MSDS) për produktet biocide në gjuhën shqipe dhe angleze, në formë të printuar dhe elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kimikatet.

g) Mostrën e produktit biocid me paketimin dhe etiketën në gjuhën shqipe, siç do të hidhet në treg;

gj) Licencën e QKB-së për vendosjen në treg të produkteve biocide;

h) Lejen mjedisore, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas shtojcës 1, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;

i) Faturën e pagesës së aplikimit.

III.5.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.5.10. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorëve ekonomikë ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KPP konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriteret e tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produkteve.

Referuar nenit 40, pika 6 gërma “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkesa për paraqitjen e mostrave, parashikohet si një ndër kërkesat e cila duhet përmbushur për kualifikimin e operatorëve ekonomikë. Pra, ligjvënësi ka parashikuar këtë kërkesë, si një kriter i cili duhet përmbushur nga operatori ekonomik, i cili synon të fitojë kontratën, si dhe t’i shërbejë autoritetit kontraktor me qëllim verifikimin nëse produktet e paraqitura plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në fazën e vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurë. Sa më sipër, kërkesa mbi momentin e dorëzimit të mostrave “jo më vonë se pesë ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar”,

përveçse është një kërkesë e cila nuk parashikohet në ligjin për prokurimin publik, akoma më tej nuk i shërben as qëllimit të autoriteti kontraktor, për të vlerësuar përputhshmërinë e produkteve të paraqitura nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara. Sipas nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkesa për dorëzimin e mostrave është një kriter kualifikimi, i cili nuk mund ta arrijë qëllimin për të cilin kërkohet, pas shpalljes së fituesit të kontratës.

Sa më sipër autoritetit kontraktor, të modifikojë kërkesën e mësipërme në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Për sa i përket, pretendimit të operatorit ekonomik lidhur me dokumentacion shoqërues të mostrave, KPP referuar pretendimit të ankimuesit thekson se referuar nenit 40 pika 6/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ligjvënësi ka parashikuar që autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, si mostrat të produkteve, dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, si dhe mund të përcaktojnë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Në interpretim të dispozitave ligjore të fushës së prokurimit, vlen të theksojmë se së prari, ligjvënësi ka parashikuar dy natyra kriteresh kualifikimi, kriteret të cilat përcaktohen me ligj, si dhe kriteret dhe kërkesa të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në përputhje me llojin, volumin, sasinë, specifikat e shërbimit që kërkohet të prokurohet, me qëllim realizimin me sukses dhe cilësi të tij. Kriteret e përcaktuara me ligj mund të parashikohen nga ligji për prokurimin publik dhe rregullat në përputhje me të, gjithashtu mund të përcaktohen kriteret të cilat bazohen në ligje specifike, në varësi të fushës apo objektit që kërkohet të realizohet.

Referuar procedurës konkrete objekt-shqyrtimi, konstatohet se blerja e mallit nga subjektet të cilat ofrojnë shërbimin objekt-prokurimi, ka një rregullim të posaçëm ligjor dhe kryhet sipas disa procedurave specifike, duke u shoqëruar me dokumentacion përkatës, për vendosjen e tyre në treg (Ligji 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe rregullat në zbatim të tij). Nga ana tjetër, në rastin konkret, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor kërkon mostra të produkteve që do të përdoren për kryerjen e shërbimit, shoqëruar me dokumentacion si: Certifikatë konformiteti ose cilësie ECHA/ekuivalent, Certifikate origjine të produktit, Raport testimi.

Sa më sipër, referuar Ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe rregullat në zbatim të tij, produktet për kryerjen e shërbimit objekt-prokurimi, pajisen me dokumentacion përkatës për vendosjen e tyre në treg në Republikën e Shqipërisë dhe duke qenë se për këtë procedurë ka një rregullim specifik, autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë për këto produkte dokumentacion shoqërues të ndryshëm nga sa parashikon ligji i posaçëm, pasi në këtë mënyrë krijon konfuzion dhe paqartësi tek operatorët ekonomikë të cilët kërkojnë të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor të modifikojë kriterin në lidhje me dokumentacionin shoqërues të mostrave, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës përkatëse, objekt-prokurimi, më qëllim për të siguruar një pjesëmarrje sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Metani” SHPK “Në dokumentet standarde të tenderit në shtojcën 8, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik autoriteti kontraktor kërkon si kriter kualifikues:

“Operatori ekonomik në lidhje me lenden e përcaktuar në specifikimet teknike, që do të paraqese, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe Certifikatë konformiteti ose cilësie EKA/ekuivalent.

Lenda që do të perdoret në shërbimin e dezinfektimit			
Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie ECHA/ekuivalent
1	Agjenti biologjik <i>Bacillus thuringiensis israelensis</i> (Bti)		
2	Bti granula (G)		
3	Monomolekular film		

Shënim:

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK certifikatat e cdo produkti jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.

Te dhenat që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.”

Shtojca 5, Pika II Specifikimet teknike për produktet

Formulimet dhe përqendrimet lëndës aktive dezinfektuese që duhet të përdoren,

1. Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), në dy formulime:
 - (i) Bti mikrogranula të dispergueshme në ujë (ĒG) me fuqi 3000 I.T.U./mg (Njësi Toksike Ndërkombëtare)/mg),
 - (ii) Bti granula (G) me fuqi 200 I.T.U (Njësi Toksike Ndërkombëtare)/mg,
2. Film monomolekular është një produkt që vepron si barrierë fizike për kontrollin e larvave të mushkonjave, duhet të jetë me bazë silikon, aplikohet në përqendrimin 1ml/m².

[...] Bazuar në argumentet ligjore, përcaktuar në ligjin 162/2020 (lex specialis), VKM nr.285 datë 19.05.2021 ndryshuar me Vendimin 710, datë 24.11.2022, VKM nr. 933 datë 25.11.2020, kërkojmë ndryshimin e kriterëve kualifikues të shtojcës 8, pika 2.3..3 kapaciteti teknik dhe shtojcës 5, pika II duke hequr specifikimet teknike përcaktimin e fuqisë 3000 ITU/mg për BTI mikrogranula të dispergueshme në ujë (ĒG) dhe 200 ITU për Bti granula (G) si një kriter ekstraligjor I pa bazuar në ligj, në kundërshtim të dispozitave ligjore në fuqi, diskriminues dhe

përcaktimin vetëm të agjentit biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti) shoqëruar me fjalët ekuivalente. [...]

*[...] Bazuar në argumentet ligjore, përcaktuar në ligjin 162/2020 (lex specialis), VKM nr.285 datë 19.05.2021 ndryshuar me Vendimin 710, datë 24.11.2022, **kërkojmë ndryshimin e kriterëve kualifikuese të shtojcës 8, pika 2.3..3 kapaciteti teknik dhe shtojcës 5, pika II duke hequr pakësuar nga specifikimet teknike përcaktimin Bti granula(G) si një kërkesë ekstraligjore I pa bazuar në ligj dhe në kundërshtim të dispozitave ligjore.***

Ne shtojcen 8, pika 2.3.3, kapaciteti teknik dhe shtojca 5, Pike ii. Autoriteti Kontraktues kërkon si kriter kualifikues produktin **Film monomolekular**, nje produkt qe vepron si barriere fizike per kontrollin e larvave te mushkonjave, duhet te jete me baze silikoni, aplikohet ne perqendrimin 1 ml/m2. Operatori Ekonomik ankimes i sjelle ne vemendje Autoritetit Kontraktor dispozitat ligjore te percaktuara Ligjin 162/2020, neni 36 pika ç) te dyja metodave te percaktuara ne shkronjat "a" dhe "b" te pikes 3 te ketij neni, per mallra, sherbime ose pune te ndryshme, te perfshira ne e njejtin objekt-kontrate. çdo reference duhet te shoqerohet nga fjalet "ose ekuivalenti i tij/saj", percaktimi i produktit ne shtojcen 5, Pika ii, nuk eshte shoqeruar nga fjalet ekuivalente ne kundërshtim me dispozitat ligjore percaktuar ne nenin 36, pika p) te ligjit 162/2020.

Mos shoqerimi me fjalet ekuivalente sipas dispozitave te parashikuara ne Ligjin 162/2020, neni 36 pika ç, kërkesa Ne shtojcen 8, pika 2.3.3, kapaciteti teknik dhe shtojca 5, Pika ii, Film monomolekular qe vepron si barriere fizike per kontrollin e larvave te mushkonjave, duhet te jete me baze silikoni, aplikohet ne perqendrimin 1 ml/m2, eshte ne kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nuk eshte e mbështetur ne legjislacionin e Prokurimit Publik.

Perdorimi i filmit monomolekular sipas percaktimin ne procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim eshte produkt i cili aplikohet ne puseta me uje jo te rrjedhshem me perberje sintetike ose prejardhje hidrokarburesh. Deshirojme te sjellim ne vemendje te autoritetit kontraktor dispozitat ligjore te ligjit 162/2020, nenit 36, per specifikimet teknike pika 3, paragrafi a) te Ligjit 1d2/2020 i cili percakton se [...]

[...] Bazuar në argumentet ligjore, përcaktuar në ligjin 162/2020 (lex specialis), VKM nr.285 datë 19.05.2021 ndryshuar me Vendimin 710, datë 24.11.2022, kërkojmë ndryshimin e kriterëve kualifikuese të shtojcës 8, pika 2.3..3 kapaciteti teknik dhe shtojcës 5, pika II duke saktësuar në specifikimet teknike përbërjen kimike të film monomolekular, shtimin në zbatim të dispozitave ligjore të nenit 36 , për specifikimet teknike fjalën ekuivalent, shtimin e përcaktimit Film monomolekular ose produkt biocid larvacid për përdorim në puseta, grupa septike me ujë jo të rrjedhshëm.

3. Operatori ekonomik duhet të deklaroj se **disponon, pajisjet dhe mjetet**, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1.	Kamiocine Teknika "Cold fogging" mjegull e	copë	1	Në pronësi ose me qira

	ftohtë.			
2.	Pompë me presion të lartë	copë	1	Në pronësi ose me qira
3.	Atomizator shpine me motor per granula	copë	1	Në pronësi ose me qira
4.	Atomizator shpine me motor me lëng	copë	1	Në pronësi ose me qira
5.	Dozator për lëng për bodrume dhe puseta	copë	3	Në pronësi ose me qira

[...] Bazuar në dispozitat e përcaktuara në nenin 77, pika 1, nenin 36 pika 3, **kërkojmë ndryshimin e shtojcës 8 pika 2.3.7.2, kapaciteti teknik dhe shtojca 5 pika iii, Kamioncinë Teknika Pompë me presion të lartë mjegullues (nebulizator) që prodhon mjegull të ftohtë, I montuar në një kamioncinë, me sistem mjegullimi në 100 litra/orë, madhësi të piklave 80 – 100 mikron, rezervuar jo më pak se 300 litra, jetë pajisur me përzierës (agitator), Presioni I pompës duhet të jetë > 5 bar dhe prurja duhet të jetë rreth 15 litër/min, në Kamioncinë Teknika Pompe me presion të lartë mjegullues (nebulizator) madhësi te piklave 80 – 100 mikron, rezervuar jo më pak se 300 litra.**

[...]Bazuar në dispozitat e përcaktuara në nenin 77, pika 1, nenin 36 pika 3, kërkojmë ndryshimin e shtojcës 8 pika 2.3.7.2, kapaciteti teknik dhe shtojca 5 pika iii, **atomizator shpine me motor lëng, pompa e shpinës duhet të ketë një volum jo më pak se 5 – 10 litra, pompa duhet të ketë pipthin në dalje me diametër 1.2 mm, tubi I daljes duhet të jetë I drejtë pa kënd, aplikimi duhet të jetë në këndin 45 gradë, rrjedhja duhet të jetë vetëm drejt, pa këndë në dalje, tanku I atomizatorit duhet të jetë jo më pak se 13 litra, Volumi I ajrit/orë të variojë nga 900 deri 1300 m3/orë, në atomizator shpine me volum jo më pak se 5 – 10 litra.**

[...]Bazuar në dispozitat e përcaktuara nenin 2 pika c,ç, d, nenin 36 pika 3 a, c, të Lpp, nenit 93 të VKM 285, pika 1, heqjen, pakësimin e shtojcës 8, pika 2.3.7.2, kapaciteti teknik dhe shtojca 5 pika iii, **atomizator shpine me motor lëng, pompa e shpinës duhet të ketë një volum jo më pak se 5 – 10 litra, Dozator për lëng për bodrume dhe puseta I cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në milimetra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për aplikimin e produktit 1ml/m2 si një kërkesë ekstraligjore I pa bazuar në ligj dhe në kundërshtim të dispozitave ligjore në fuqi si një kriter diskriminues.**”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor konstatohet, se ky i fundit në aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Metani” SHPK ka pranuar pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “Metani” SHPK, duke argumentuar si vijon: “[...]Operatori Ekonomik “METANI” SHPK ka ankimuar kriterin e vendosur në pikën 3, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8, si dhe specifikimet teknike lidhur me këtë kriter të përcaktuara në dokumentet e tenderit, me pretendimet si vijon: “Përcaktimi i Produktit agjenti biologjik *Bacillus thuringensis israelensis* (Bti), në dy formulime mikrogramula të dispergueshme në ujë (EG) me fuqi 3000 I.T.U./mg dhe Bti granula (G) me fuqi 200 I.TU./mg. Duke i sjellë në vëmendje Autoritetit Kontraktor dispozitat ligjore të përcaktuara Ligjin 162/2020, neni 36 pika ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të

ndryshme, të përfshira në të njëjtin Objekt kontrate. Cdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”, përcaktimi i produktit në shtojcën 5, pika ii, nuk është shoqëruar nga fjalët ekuivalente në kundërshtim me dispozitat ligjore përcaktuara në nenin 36, pika ç) të ligjit 162/2020.

I.1.1. Sipas regjistrimit në agjencitë ECHA dhe EPA <https://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-active-substances/-/disas/factsheet/5/PT18> produktet me agjent biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), në dy formulime. Bti mikrogranula të dispergueshme në ujë (EG) me fuqi 3000 I.T.U./mg Njesi Toksike Nderkombetare/mg) dhe Bti granula (G) me fuqi 200 I.T.U. janë vetëm re dy prodhuesve dhe markave. Ndërsa formulimet me të njëjtin agjent biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), janë disa produkte me formulime të fuqisë I.T.U./mg Njesi Toksike Nderkombetare/mg) të ndryshme nga sa kërkuar në shtojcën 8, pika 2.3.3, kapaciteti teknik dhe shtojca 5, Pika ii. Në Argumentimin e specifikimeve teknike Autoriteti kontraktor nuk specifikon qartësisht arsyet e përzgjedhjes së fuqisë I.T.U./mg (Njesi Toksike Nderkombetare/mg) dhe Bti granula (G) me fuqi 200 I.T.U. Specifikimet teknike lidhur me fuqinë e produktit agjent biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), në dy formulime:Duke i sjellë në vëmendje Autoritetit Kontraktor Ligjin 162/2020, nën 36 pika 4: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objektin e kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patente, tipin e origjinës apo prodhues specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në rastet përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente". Bazuar në listën e produkteve të regjistruara në ECHA dhe të regjistruara gama e produkteve me agjent biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* me fuqi I.T.U. të ndryshme nga kërkesa në shtojcën 5, Pika ii. Oferta e produkteve është e larmishme dhe nga të njëjtat prodhues të dy produkteve kërkuar si kriter kualifikues në shtojcën 8, pika 2.3.3, kapaciteti teknik dhe shtojca 5, Pika ii. Bazuar në regjistrin e ECHA: Information on biocides (europa.eu) Autoriteti Kontraktor nuk është në kushtet e mungesës së një mënyre të mjaftueshme, saktë apo kuptueshme të objektit të kontratës. Vendosja e përqendrimit me fuqi 3000 I.T.U./mg për Bti mikrogranula të dispergueshme në ujë (VG) dhe 200 I.T.U. për Bti granula (G) është në kundërshtim me dispozitat ligjore duke përcaktuar ekzaktësisht markën dhe prodhuesin e agjentit biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti). Përcaktimi i markës dhe prodhuesit paracakton detyrimisht Operatorin ekonomik pjesëmarrës në kundërshtim me dispozitat ligjore Ligjit 162/2020... Në shtojcën 8, pika 2.3.3, kapaciteti teknik dhe shtojca 5, Pike ii. Autoriteti Kontraktues kërkon si kriter kualifikues produktin Film monomolekular, një produkt që vepron si barriere fizike për kontrollin e larvave të mushkonjave, duhet të jetë me bazë silikon, aplikohet në përqendrimin 1 ml/m². Operatori Ekonomik ankimes i sjellë në vëmendje Autoritetit Kontraktor dispozitat ligjore të përcaktuara Ligjin 162/2020, nën 36 pika ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt

kontrate. Jdo reference duhet te shoqerohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj", percaktimi i produktit ne shtojcen 5, Pika ii, nuk eshte shoqeruar nga fjalet ekuivalente ne kundërshtim me dispozitat ligjore percaktuar ne nenin 36, pika p) te ligjit 162/2020.

Mosshoqerimi me fjalet ekuivalente sipas dispozitave te parashikuara ne Ligjin 162/2020, neni 36 pika ç, kërkesa Ne shtojcen 8, pika 2.3.3, kapaciteti teknik dhe shtojca 5, Pika ii, Film monomolekular qe vepron si barriere fizike per kontrollin e larvave te mushkonjave, duhet te jete me baze silikoni, aplikohet ne përqendrimin 1 ml/m2, eshte ne kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nuk eshte e mbështetur ne legjislacionin e Prokurimit Publik.

Perdorimi i filmit monomolekular sipas percaktimin ne procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim eshte produkt i cili aplikohet ne puseta me uje jo te rrjedhshem me perberje sintetike ose prejardhje hidrokarburesh. Deshirojme te sjellim ne vemendje te autoritetit kontraktor dispozitat ligjore te ligjit 162/2020, neni 36, per specifikimet teknike pika 3, paragrafi a) te Ligjit 162/2020 i cili percakton se. Specifikimet teknike duhet te pershkruajne qarte kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke in referuar kërkesave funksionale ose te performances, perfshire karakteristikat mjedisore, me kusht qe parametrat te jene te sakte ne menyre qe t'u japin mundesi ofertuesve te percaktojne objektin e kontrates dhe autoriteteve ose enteve kontraktore te japin kontraten.

Ne shtojcen 8, pika 2.3.3, kapaciteti teknik dhe shtojca 5, Pika ii. autoriteti kontraktor nuk ka percaktuar perberjen kimike te filmit monomolekular duke mos zbatuar dispozitat e neni 36, per specifikimet teknike pika 3, paragrafi a) të Ligjit 162/2020, duke mos përcaktuar saktë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke mos iu referuar parametrave të saktë në mënyrë që të jepet mundësi OE të përcaktojë kontratën

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi dokumentet e tenderit, si dhe pretendimet e parashtruara ne ankese nga operatori ekonomik ankimues "METANI" SHPK, dhe konstatoi:

Në pikën 3 të seksionit 2.3, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8, në dokumentet e tenderit, është përcaktuar: 3.Operatori ekonomik ne lidhje me lenden e percaktuar ne specifikimet teknike, që do te paraqese, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe Certifikatë konformiteti ose cilësie ECHA/ekuivalent.

Lenda qe do te perdoret ne sherbimin e dezinfektimit

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie ECHA/ekuivalent
-----	----------------------	-------------------	--

1	Agjenti biologjik Bacillus thuringiensis israelensis (Bti)		
---	--	--	--

2	Bti granula (G)		
---	-----------------	--	--

3	Monomolekular film		
---	--------------------	--	--

Shënim:

Në zbatim të ndryshimeve te reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK certifikatat e cdo produkti jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit perfundimtar. Te dhenat qe do te deklarohen, detyrimisht do t'i paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Ne pikën ii, në Specifikimet teknike, Shtojca 5, është përcaktuar: “Formulimet dhe përqendrimit e lëndës aktive dezinfektuese që duhet të përdoren:

1. Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), në dy formulime:

(i) Bti mikrogranula të dispergueshme në ujë (EG) me fuqi 3000 I.T.U./mg (njësi Toksike Ndërkombëtare)/mg),

(ii) Bti granula (G) me fuqi 200 I.T.U (Njësi Toksike Ndërkombëtare)/mg,

2. Film monomolekular është një produkt që vepron si barrierë fizike për kontrollin e larvave të mushkonjave, duhet të jetë me bazë silikoni, aplikohet në përqendrimin 1ml/m².

Ne datë, 24.05.2022, organi qendror blerës i është drejtuar me shkresë nr. 841 prot., Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me lëndë “Kërkesë për informacion”, duke kërkuar informacionin si vijon:

- A janë produktet e sipërcituara (te cituara ne pikën 3, të seksionit 2.3, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit) lëndë Biocide?

- Nëse po, lutemi të na informoni, për secilin produkt, sa subjekte disponojnë Autorizim për tregtimin e tyre.

Në datë 03.06.2022, nëpërmjet shkresës nr. 841/1 (protokolluar me tonën), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka kthyer përgjigje si vijon:

“Lidhur me pyetjen 1.

Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti) është një lëndë aktive që përdoret në përbërje të produkteve biocide ... Filmi monomolekular me bazë silikoni, vepron thjeshtë si barrierë fizike për kontrollin e larvave dhe pupave të mushkonjave dhe për këtë arsye nuk karakterizohet si lëndë biocid.

Lidhur me pyetjen 2:

Subjekti i cili disponon Autorizim për vendosjen në treg për produktet biocide, të cilat kanë në përbajtje lëndën aktive *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), është subjekti “NRG” SHPK”.

Në nenin 2 “Qëllimi”, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, është përcaktuar [...]

Ne paragrafin e parë, të pikës 1, të nenit 21, të LPP-së, parashikohet: [...]

Pika 2, 3, 4 e nenit 36 të po këtij ligji, shprehet: [...]

Në pikën 7, e nenit 4, përcaktohet: “Ekuivalente” është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlershme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit.

Ne respekt të parimeve të mësipërme, dhe gjithë bazës ligjore të sipërcituar, kriteret dhe specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përfshijnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoriteti kontraktor duhet të shmangë çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, apo të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

KSHA gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë.

Ne hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike, autoritetet kontraktorë duhet të mbajë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishëm perbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Nga interpretimi i mësipërm, arrijme ne përfundimin, se e rëndësishme është që përmes vendosjes së kriterëve dhe specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejte, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

KSHA-ja gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 germa “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriterë që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriterë dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, por pa përcaktuar kërkesa të cilat krijojnë konfuzion, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriterë apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë, për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik.

Në këto kushte, në respektim të parimeve të ligjit “Për Prokurimin Publik” si dhe duke mbajtur në konsideratë shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ku citon: “Subjekti i cili disponon Autorizim për vendosjen në treg për produktet biocide, të cilat kanë në përmbajtje lëndën aktive *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), është subjekti “NRG” SHPK”, KSHA gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike të produkteve të përcaktuara në pikën 3, të seksionit 2.3, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kërkesat e mësipërme me qëllim që të sigurojë artikullin e mësipërm në përputhje me nevojat e tij njëkohësisht duke hapur dhe konkurrencën drejtë operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

Për sa më sipër, pretendimet e ankimuesit “METANI” SHPK, pranohet.

2. Operatori Ekonomik, “METANI” SHPK ka ankimuar specifikimet teknike lidhur me kriterin e përcaktuar në pikën 7, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8, në dokumentet e tenderit, me pretendimet si vijon: “Në teknikën me mjegullim për objektin e kontratës se shpallur nga autoriteti kontraktor, e rendesishme është madhësia në micron e pikles për të mundësuar depërtimin në ambientet sa më të vogla aty ku mënyra të tjera të shpërndarjes së produktit nuk mundet të arrijnë, përcaktim teknik i cili është përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Në zbatim të dispozitës ligjore të nenit 77, pika 1, LPP kërkesat për kualifikim duhet të jene proporcionale të objektin e kontrate. Kërkesat lidhur me presionin e pompën 5 bar dhe prurja duhet të jetë rreth 15 litër/min dhe mjegullim 100 litra/orë, nuk janë në proporcion me objektin e kontratës pasi nuk influencojnë në kapacitetin dhe aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik. Këto kërkesa janë në kundërshtim me nenin 36, pika 3, c). Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetin ose entitet kontraktor, duke iu referuar kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës a, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale. Specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, presioni i pompës 5 bar dhe prurja duhet të jetë rreth 15 litër/min dhe mjegullim 100 litra/orë, depozite e pajisur me perzieres janë specifikime teknike të cilat nuk lidhen ngushtë me objektin e kontratës dhe si të tilla janë kritere ekstra ligjore, diskriminuese dhe në kundërshtim me legjislacionin. Kriteret e kërkuara në specifikimet teknike janë në kundërshtim me nenin 36, pika 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Kërkesa e specifikimeve presioni i pompës 5 bar dhe prurja duhet të jetë rreth 15 litër/min dhe mjegullim 100 litra/orë, depozite e pajisur me perzieres është një kërkesë e cila saktëson një proces të veçantë jashtë objektit të kontratës se shpallur dhe specifikimit teknik të teknikes së përdorimit kërkuar në shtojcën 5,..... Bazuar në dispozitat e përcaktuara në nenin 77, pika 1, nenin 36, pika 3, c), dhe pika 4, kërkojmë ndryshimin e shtojcës 8, pika 2.3.7.2, kapaciteti teknik dhe shtojca 5 Pika iii, Kamiocine Teknike Pompë me presion të lartë mjegullues (nebulizator) që prodhon mjegull të ftohtë, i montuar në një kamionçinë, me sistemi i mjegullimit në 700 litra/orë, madhësi të piklave 80 — 100 mikron, rezervuar jo më pak se 300 litra, jetë i pajisur me përzierës (agritator), Presioni i pompës duhet të jetë 5 bar dhe prurja duhet të jetë rreth 15 litër/min, në Kamiocine Teknika Pompë me presion të lartë mjegullues (nebulizator) madhësi të piklave 80 — 100 mikron, rezervuar jo më pak se 300 litra.

IV.II Në shtojcën 8, pika 2.3.7.2y kapaciteti teknik dhe shtojca 5 Pika iii, autoriteti kontraktor kërkon si kriter kualifikues disponimin atomizator shpine me motor me lëng, pompa e shpinës duhet të ketë një volum jo më pak se 5-10 litra, pompa duhet të ketë pipthin në dalje me një diametër (D 1.2 mm. tubi i daljes duhet të jetë i drejt pa kënd* aplikimi duhet të jetë në kendin 45

0 njedhia duhet të jete vetëm drejt, pa kënde në dalje, tanku i atomizatorit duhet të jete jo më pak se 13 litra. Volumi i ajrit /orë të variojë nga 900 deri në 1300 m³/orë, Shpejtësia minimale e ajrit në dalje të jete 80 mis. Bazuar ne teknikat e percaktuara ne shtojcen 5, autoriteti kontraktor ka percaktuar tekniken e perdorimit per secilin mjet dhe tipologjine e produktit agjent biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), produkti rregullator i rritjes larvacid, ne kerkesen per atomizator slipine, I cili eshte procesi e mjegullimit autoriteti kontraktor kerkon: pompa duhet të kete pipthin ne dalje me nje diametër 0 1.2 mm, ne tekniken me mjegullim per objektin e kontrates se shpallur nga autoriteti kontraktor, e rendesishme eshte madhesia ne micron f pikles per te mundesuar depertimin ne ambientet sa me te vogla aty ka menyra te tjera te shperndarjes se produktit nuk mundet te arrijne, percaktim teknik i cili eshte percaktuar nga autoriteti kontraktor, kerkesa e autoritetit kontraktor lidhur me diametrin e pipthit ne dalje nuk lidhet ngushtesisht me objektin e kontrates e cila eshte madhesia ne micron e pikles e cila nuk është përcaktuar për atomizator shpine me motor me lëng kërkon aplikimi duhet të jetë në këndin 450, rrjedhja duhet të jetë vetëm drejt, pa kënde në dalje volumi i ajrit /orë të variojë nga 900 deri në 1300 m/orë.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi dokumentet e tenderit, si dhe pretendimet e parashtruara në ankesë nga operatori ekonomik ankimues “METANI” SHPK, dhe konstatoi:

[...]

Në këto kushte, KSHA gjykon se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë specifikimet teknike të pajisjeve të përcaktuara në pikën 7, të seksionit 2.3, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në dokumentet e tenderit, duke shmangur përcaktimet fikse, dhe duke vendosur në rastet kur kjo është e mundshme intervale apo diapazon parametrash.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kërkesat e mësipërme, me qëllim që të sigurojë realizimin e shërbimit të kerkuar në përputhje me nevojat e tij njëkohësisht duke hapur dhe konkurrencën drejtë operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

Për sa më sipër, pretendimet e ankimuesit “METANI” SHPK, pranohet pjesërisht.

Për sa më sipër, referuar ndryshimeve të gjykuara lidhur me kriteret dhe specifikime të dokumenteve të tenderit, bazuar në nenin 98, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme”, me qëllim rishikimin e specifikimeve të reja dhe ritestimin e çmimeve përkatëse, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, sugjeron anulimin e procedurës së prokurimit objekt – ankimimi..”

III.6.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.”.

III.6.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.6.4. Në nenin 101 “Hapat për shqyrtimin e ankesave në autoritetin/entin kontraktor” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti/enti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:

1. Titullari i autoritetit/entit kontraktor, me urdhër të veçantë, cakton një person ose ngre një komision të përbërë nga të paktën 3 (tre) persona për shqyrtimin e ankesës. Të paktën njëri nga anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesës duhet të jetë ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave ose ekspertit të fushës, anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave.

2. Personi përgjegjës për prokurimin duhet të kujdeset që të njoftojë ankimuesit dhe operatorët ekonomikë të interesuar, të përfshirë në proces për çdo vendim në procesin e shqyrtimit të ankesës edhe në adresën elektronike të përcaktuar 110 prej tyre në formularin e ankesës, jo më vonë se ditën e nesërme të punës pas marrjes së çdo vendimi.

3. Në rastin kur ankesa është pranuar plotësisht dhe nuk ka pasur argumente nga operatorët ekonomikë të interesuar, titullari i autoritetit/entit kontraktor njofton Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me këtë vendimmarrje dhe adreson zbatimin pas marrjes së vendimit deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.

4. Në rastet kur afatet kohore të procedurës së prokurimit, për të cilat janë njoftuar ofertuesit, ndryshojnë për shkak të marrjes parasysh të ankesës, autoriteti/enti kontraktor u shpërndan ofertuesve një njoftim të posaçëm, ku jepen arsyet për zgjatjen e këtyre afateve.”.

III.6.5. Sa më sipër, konstatohet, se autoriteti kontraktor në aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ka pranuar ndryshimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike të mësipërme, në mënyrë të përgjithshme, por nuk ka përcaktuar konkretisht se cilat janë modifikimet referuar pretendimeve të ankimuesit, duke krijuar konfuzion si për operatorin ekonomik ankimues, ashtu edhe për Komisionin e Prokurimit Publik gjatë shqyrtimit të kësaj anese. Pra, autoriteti kontraktor në mënyrë narrative pranon modifikimin e kërkesave të mësipërme, por nuk i ka pasqyruar konkretisht ato. Për sa kohë këto pretendime janë pranuar nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik nuk mund të shprehet në lidhje me to. Ndërkohë autoriteti kontraktor duhet të sqarojë dhe përcaktojë qartë veprimet e saj procedurale, siç është shprehur KSHA.

Akoma më tej, vetë autoriteti kontraktor, si organi përgjegjës i zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, në aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Metani” SHPK, KSHA pranon, se për shkak të ndryshimeve të gjykuara lidhur me kriteret dhe specifikimet e dokumenteve të tenderit, bazuar në nenin 98, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, me qëllim rishikimin e specifikimeve të reja dhe ritestimin e çmimeve përkatëse, ka sugjeruar anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimimi. Pra vetë autoriteti kontraktor, ka pranuar se ka arsye themelore, siç janë gabimet në dokumentet e tenderit, ritestimi i çmimeve përkatëse, e rrjedhimisht rishikimi i fondit të procedurës objekt-shqyrtimi, për anulimin e kësaj procedure prokurimi. Në rastin konkret, në rast se autoriteti kontraktor pas ritestimit të tregut do të vendosë rishikim të fondit limit, duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme, duke ndërmarrë veprimet procedurale të sugjeruara nga KSHA.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Air” SHPK për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”* me Nr. REF-26182-04-22-2022, me objekt Loti 3 *“Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane Qarku Fier”*, me fond limit 15.764.800 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 26.05.2022, nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Air” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik “Metani” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 4. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në përputhje me konstatimet e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.
 5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimues “Air” SHPK.
 7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimues “Metani” SHPK.
 8. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
 9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri